



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/79  
Datë: 25.05.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 paragrafi 4 të Ligjit Nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-017, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 maj 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Emërohet z.Hekuran Nikçi Kryeinspektor i Inspektoratit të Punës të Republikës së Kosovës (këtëj e tutje referuar si "Kryeinspektor"), me mandat 4 vjeçar.
2. Kryeinspektori i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi, ka për detyrë t'i kryejë funksionet e përcaktuara me Ligjin Nr.2002/9 për Inspektoriatin e Punës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-017.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

*PËR*   
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/79  
Datë: 25.05.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr. 10/69 të datës 13 prill 2022 lidhur me mbështetjen e qytetarëve të Republikës së Kosovës në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, të Vendimit të Qeverisë Nr.13/19 të datës 14 korrik 2021, lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25 gusht 2021, me Vendimin Nr. 01/49 të datës 17 dhjetor 2021 dhe me Vendimin Nr. 15/62 të datës 23 shkurt 2022 (tutje referuar si 'Vendimi lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike'), në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 maj 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në vlerë prej 35,035,000 €, (tridhjetëpesë milionë e tridhjetepesë mijë euro ), për zbatimin e Vendimit lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, si në vijim:
  - 1.1. 35,000,000.00 € (tridhjetepesë milionë euro) në kuadër të Masës 3.6 - Mbështetja e likuiditetit familjar, përkatësisht për zbatimin e pikave 1.3 dhe 1.5 të Vendimit të Qeverisë Nr.10/69 të datës 13 prill 2022, si masë për shtimin e mbështetjes për qytetarët e Republikës së Kosovës, në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, në nën-programin "Thesari" me kod 11200, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere"; dhe
  - 1.2. 35,000.00 € (tridhjetepesë mijë euro) në kuadër të Masës 4.4 - Mbështetja e Sigurisë, në Ministrinë e Mbrojtjes me kod 217, në nën-programin "Administrata Qendrore" me kod 11317, kategoria e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime".
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nga nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**  
PËR   
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/79  
Datë: 25.05.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 49, të nenit 50 dhe të nenit 52 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, të nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L - 175 për Borxhet Publike, të nenit 24 të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 maj 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen në parim kërkesat për huamarrje deri në vlerën prej 34,275,000.00 € (tridhjetëe katër milionë e dyqindeshtatëdhjetëepesë mijë euro), subjekt i aprovimit nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, për ndërmarrjet publike si në vijim:
  - 1.1. Për KOSTT Sh.A vlera e huamarrjes deri në 26,500,000.00 € (njëzetegjashtë milionë e pesëqind mijë euro); dhe
  - 1.2. Për Telekom i Kosovës Sh.A vlera e huamarrjes deri në 7,775,000.00 € (shtatë milionë e shtatëqindeshtatëdhjetepesë mijë euro).
2. Obligohet Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve që të zhvillojë të gjitha procedurat e nevojshme për sigurimin e këtij financimi nga të hyrat e borxhit publik.
3. Obligohet Thesari që për të gjitha huadhëniet ndaj ndërmarrjeve publike të bëjë transferet dhe regjistrimet e nevojshme në regjistrat kontabël në kuadër të Sistemit Informatik për Menaxhimin e Financave të Kosovës.
4. Mjetet e huadhënies sipas këtij Vendimi përdoren vetëm për qëllimin e miratuar dhe nuk janë subjekt i asnjë kufizimi, pretendimi dhe detyrimi nga palët e treta.
5. Obligohet e Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI  
PËR   
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë